



+ B A R T O L O M E U

Me mëshirën e Perëndisë, Kryepeshkop i Konstandinopojës - Romës së Re dhe Patriark Ekumenik; për të Gjithë Plotësinë e Kishës Hiri, Mëshira dhe Paqja nga Shpëtimtari Krisht i lindur në Betlehem

Shumë të nderuarve vëllezër Hierarkë,

Fëmijë të dashur në Zotin,

Me hirin e Perëndisë edhe këtë vit kremtojmë me psalme, himne dhe këngë shpirtërore Lindjen në trup të Krishtit Birit dhe Fjalës së Perëndisë së përjetshëm, përkatësisht shfaqjen e misterit të Perëndisë dhe njerëzimit. Sipas Shën Nikolla Kabasilës, ajo që ndodh në Liturgjinë Hyjnore është “mistagogjia e mishërimit të Zotit”, ndërsa thirrja e saj hyrëse “*E bekuar është Mbretëria e Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë*” është dëshmi “*se është nëpërmjet mishërimit të Zotit që njerëzit së pari mësuuan se Perëndia është tre persona*”. [1] I njëjti At i shenjtë shpall se; “*Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jesu Krisht ishte i pari dhe i vetmi që tregoi qenien njerëzore autentike dhe të përsosur, përse i përket karakterit të Tij, jetës dhe gjithçkaje tjetër*”. [2]

Marrja e natyrës njerëzore në personin e Birit dhe Fjalës së Perëndisë, së bashku me hapjen e rrugës së hyjnizimit njerëzor nëpërmjet hirit, i shton njerëzimit një vlerë të patejkalueshme. Harrimi i kësaj të vërtete çon në zvogëlimin e respektit për personin njerëzor. Mohimi i fatit suprem të qenieve njerëzore jo vetëm që i çliron ata, por gjithashtu çon në reduktime dhe ndarje të ndryshme. Pa qenë të vetëdijshëm për origjinën e tyre hyjnore dhe shpresën e tyre për përjetësinë, njerëzit luftojnë të mbeten njerëz dhe nuk janë në gjendje të përballojnë kontradiktat e “gjendjes njerëzore”.

Perceptimi i krishterë i ekzistencës njerëzore ofron një zgjidhje për problemet e krijuara nga dhuna, lufta dhe padrejtësia në botën tonë. Respekti për personin njerëzor, paqja dhe drejtësia janë dhurata nga Perëndia; megjithatë, vendosja e paqes që vjen nga Krishti kërkon pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e qenieve njerëzore. Pikëpamja e krishterë për luftën për paqe qëndron në fjalët e Krishtit, Shpëtimtarit tonë, i cili shpall paqen, duke iu drejtuar dishepujve të Tij me përshëndetjen “*Paqja qoftë me ju*” dhe duke na inkurajuar të duam armiq të tanë [3]. Zbulosa në Krishtin quhet “ungjilli i paqes”. [4]

Kjo do të thotë se, për ne të krishterët, rruga drejt paqes është përmes paqes dhe se jodhuna, dialogu, dashuria, falja dhe pajtimi kanë përparësi përpara formave të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Teologjia e paqes përshkruhet qartësisht në dokumentin e Patriarkanës Ekumenike “*Për Jetën e Botës: Drejt një Karakteri Shoqëror të Kishës Ortodokse*” (2020):

“*Asgjë nuk është më shumë në kundërshtim me vullnetin e Perëndisë për krijesat e Tij të krijuara sipas shëmbëlltyrës dhe ngjashmërisë së Tij, sesa dhuna kundrejt tjetrit . . . Me të drejtë mund të themi se dhuna është mëkat ‘par excellence’. Është kontradikta e përsosur e natyrës sonë të krijuar dhe thirrjes sonë të mbinatyrshme për të kërkuar bashkim në dashuri me Perëndinë dhe të afërmin tonë . . .*”

Paqja është një zbulim i vërtetë i realitetit akoma më të thellë të krijimit, ashtu siç e synon Perëndia dhe ashtu siç e ka krijuar Perëndia në këshillat e Tij të përjetshme.” [5]

Paqja nuk mund të merret si e mirëqenë; nuk është e vetëkuptueshme. Është një detyrim, një arritje dhe një luftë e pandërprerë për ta ruajtur atë. Nuk ka zgjidhje automatike apo receta të përhershme. Përballë kërcënimeve të vazhdueshme ndaj paqes, duhet të kemi vigjilencë dhe vullnet për t'i zgjidhur problemet përmes dialogut. Heronjtë e mëdhenj të politikës janë kampionët e paqes. Sa për ne, ne vazhdojmë të nënvizojmë rolin paqebërës të fesë. Kjo është në një kohë kur fetë kritikohen se ushqejnë fanatizëm dhe dhunë “në emër të Perëndisë” në vend që të jenë forca paqeje, solidariteti dhe pajtimi. Megjithatë, kjo tregon një tjetërsim të besimit fetar dhe jo pjesë përbërëse të tij. Besimi i vërtetë në Perëndi është kritiku më i ashpër i fanatizmit fetar. Fetë janë aleatët natyrorë të të gjitha qenieve njerëzore që përpiqen për paqen, drejtësinë dhe ruajtjen e krijesës nga shkatërrimi njerëzor.

Këtë vit, bota nderon 75-vjetorin e “*Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut*” (10 dhjetor 1948), që përbën një përmbledhje të idealeve dhe vlerave themelore humanitare, “*standardin e përbashkët, të cilin duhet t'a synojnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet*”. Të drejtat e njeriut, pika qendrore e të cilave përfshin mbrojtjen e dinjitetit njerëzor me kushtet e tij individuale, shoqërore, kulturore, ekonomike dhe ekologjike, janë të kuptueshme në dinamikën e tyre origjinale vetëm nëse ato njihen si bazë dhe kriter i paqes globale, duke e shoqëruar atë me liri dhe drejtësi. Në këtë kuptim, e ardhmja e të drejtave të njeriut dhe e paqes është e lidhur edhe me kontributin e feve në çështjen e respektimit të tyre dhe bërjen e tyre realitet.

Me këto mendime dhe ndjenja festive, me bindje të plotë se jeta e Kishës në vetvete përbën rezistencë kundër çnjerëzimit, kudo ku shfaqet një çnjerëzim i tillë, ju ftojme të gjithëve në luftën e mirë të ndërtimit të një kulture paqeje dhe solidariteti, ku njerëzit do të shohin në fytyrën e qenieve të tjera njerëzore një vëlla apo motër dhe një mik, sesa një kërcënim dhe armik. Për më tepër, ju kujtojmë të gjithëve, të dashur vëllezër Hierarkë dhe fëmijë në Zotin, se Krishtlindja është një kohë e vetëdërgjegjësimit dhe falenderimit, e zbulimit të dallimit midis Perëndi-njeriut dhe “njeriut-perëndi”, e kryerjes së “mrekullisë së madhe” e lirisë në Krishtin dhe e shërimit të “plagës së madhe” të largimit nga Perëndia. Së fundi, gjunjëzohemi me respekt para Marisë, Nënës së Perëndisë, e cila mban në krahët e saj Fjalën e mishëruar dhe ju përcjellim juve bekimin e të Shenjtës dhe të Madhes Kishë Mëmë të Krishtit, duke ju uruar një jetë të mbarë, të shëndetshme, të frytshme, paqësore dhe një Vit të Ri të gëzueshëm sipas pëlqimit të Zotit.

Krishtlindje 2023

+ **BARTOLOMEU** i Konstandinopojës

Lutësi i zjarrtë i ju të gjithëve përpara Perëndisë

1. *Mbi Liturgjinë Hyjnore XII*, PG 150.392D.
2. *Mbi Jetën e Krishtit VI*, PG 150.680C.
3. Cf. Mt. 5:44
4. Ef. 6:44
5. § 42, 43 dhe 44